



Portali

Bibla Shqip

Materiale

Apologjia

Fete & Kultet

Burime-Info

Kush Jemi

Abonohuni

Vizioni ynë:

*"Që t'ju shërbejmë
shqiptarëve për
Krishtin."*

Prezantimi i Biblës së Studimit Jeta e Plotë ([versioni online](#))

Të shtunën, më datë 4 nëntor 2006, tek Kisha e Perëndisë në Tiranë, u bë prezantimi i Dhjatës së Re (Versioni Diodati i Ri) për Biblën e parë të studimit në shqip me emrin "Bibla e Studimit Jeta e Plotë". Kjo Bibël erdhi si rezultat i disa viteve punë për përkthimin nga anglishtja dhe redaktimin e saj në gjuhën shqipe dhe pritet të ketë një ndikim pozitiv në trajnimin dhe mbështetjen e punës së pastoreve dhe besimtarëve të tjerë që do ta përdorin.

"Bibla e Studimit Jeta e Plotë" është një Bibël e cila përveç tekstit biblik përmban edhe shënime në formë komentari për shumë vargje dhe si e tillë ajo është ideale për pastorët, studiuesit dhe për të gjithë ata besimtarë që duan ta marrin më seriozisht studimin e Biblës. Kjo Bibël studimore ka një perspektivë apo qasje pentakostale/karizmatike e cila ka ndikuar edhe në përcaktimin e emrit si "Jeta e Plotë". Ndërkohë, titulli i versionit origjinal në anglisht është "Full Life Study Bible".

Kjo Bibël studimi përmban shënime studimi të shkruara në fund të pothuajse çdo faqeje si dhe shumë artikuj, harta, tabela dhe parathënie për çdo libër të Dhjatës së Re (në parathënie përfshihen shënime për autorin, tema, data e shkrimit, sfondi historik i librit, qëllimi, një vështrim i përgjithshëm mbi secilin libër, karakteristika të veçanta dhe një plan leximi ditore). Në Biblën e studimit është i përfshirë edhe një sistem referencash të kryqëzuara studimi, një konkordancë, një indeks për subjektet dhe një indeks për të gjetur temat.

Versioni i tanishëm në shqip përmban vetëm Dhjatën e Re. Ndërkohë, teksti i Biblës është i njëjti përkthim që përdoret në Shqipëri, pra versioni Diodati i Ri nga Shoqata Shqiptare e Biblës (The Albanian Bible Society – ABS).

Termi "Jeta e Plotë" i referohet theksit të veçantë që i vihet perspektivës, doktrinës dhe përvojës pentakostale/karizmatike të kësaj Bible studimi.

Origjina e "Biblës së Studimit Jeta e Plotë"

Bibla e Studimit Jeta e Plotë u përgatit nga misionari i Asamblesë së Perëndisë në Brazil, Donald Stamps dhe u publikua për herë të parë në vitin 1991. Z. Stamps, vdiq nga kanceri pak javë para se vepra e tij të botohej. Ai u shpreh duke thënë: "Qëllimi kryesor i kësaj Bible studimi është t'ju çojë ju, lexuesit, drejt besimit në Shkrimin e Shenjtë dhe sidomos drejt një besimi më të thellë në mesazhin apostolik të Dhjatës së Re dhe t'ju ndihmojë të përjetoni po atë përvojë të Dhjatës së Re që u bë e mundur nga plotësia e Krishtit që jeton në kishë (Efe. 4:13) si dhe nga plotësia e Frymës së Shenjtë që jeton tek besimtari (Vep. 2:4; 4:31)."

Takimi prezantues u drejtua nga Herb Griffin, drejtori i shtëpisë botuese "Life Publishers" (sponsor i kësaj Bible studimi) dhe Kurt Plagenhoef, presidenti i Këshillit të Përgjithshëm të Asamblesë së Perëndisë në Shqipëri.

Miqtë e Zembrës nga E. Stanley Ott ([versioni online](#))

Në ditët e sotme jetët tona janë mjaft të ngarkuara me punë dhe ne kemi më pak miq të ngushtë sesa kishim 10 vjet më parë. Konsideroni dy lloje miqsh: miq të rrugës dhe miq të zembrës.

Një mik i rrugës është një shok që ecën me ju në rrugën e jetës. Mund të jeni komshinj ose të punoni në të njëjtën zyrë, të shkoni në të njëjtën shkollë ose kishë. Ju i doni me të vërtetë miqtë e rrugës. Megjithatë, kur rruga mbaron, kur dikush nga ju zhvendoset diku tjetër ose largohet nga puna, miqësia përfundon.

Nga ana tjetër, mes miqve të zembrës ka një lidhje të tillë të fortë, që kur rrugët ndahen, miqësia vazhdon. S'ka rëndësi nëse keni qenë 10,000 milje larg dhe s'e keni parë njëri - tjetrin për vite, kur takoheni, duket sikur koha nuk ka ecur fare. "Shpirti i Jonathanit mbeti i lidhur me shpirtin e Davidit dhe Jonathani e deshë si shpirtin e vet". 1 Samuelit 18:1.

Merrni vendimin që gjatë rrugës të zini sa më shumë miq që të jetë e mundur dhe lutuni që disa prej tyre të hyjnë në zembrën tuaj.

Për mua, dy nga mënyrat më të frytshme që kanë bërë të lindin miqësi zemre janë: të ftosh njerëz për të ngrënë një vakt dhe për të studiuar Biblën sëbashku. Ndarja e ushqimit është diçka e veçantë që e thëllon miqësinë mes njerëzve. Në një mënyrë të ngjashme, studimi i Biblës është një eksperiencë e veçantë kur disa persona mblidhen për të ndarë nga Fjala dhe për t'u lutur, një gjë e tillë rrit miqësitë e zembrës.

Jezusi tha: "Ju kam thirrur miq" (Gjoni 15:15). Lavdi Zotit si për miqësitë tuaja të rrugës ashtu edhe për ato të zembrës! Kërkoni inkurajimin e Zotit ndërsa zini miqësi të reja!

Copyright: E. Stanley Ott www.buildingoneanother.org
October 3, 2006 e-Volume 5, No. 40 Friends of the Heart

Inagurohet në Durrës ndërtesa e re për Kishën e Jezus Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Fundit

Në fillim të muajit nëntor 2006, disa media njoftuan për inagurimin e një ndërtese të re në zonën e ish-moçalit në Durrës. Kjo ndërtesë i përkiste Kishës së Jezus Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Fundit, ndryshe njohur si Mormonët.

Ndërtesa e re, e një stili mjaft të spikatur Mormon, ishte fruti i një investimi prej 1 milion dollarësh, në një zonë të Durrësit ku popullsia ka qenë vazhdimisht në rritje dhe që dukshëm është me mjaft interes për planet e këtij sektit tashme prezent në Shqipëri që në vitet e para të futjes së demokracisë.

Fakti është që ky sekt po përpiqet të forcohet dhe të zgjerohet gjithmonë e më tepër në Shqipëri dhe në mesin e shqiptarëve në përgjithësi. Megjithëse opinioni i gjerë është shumë pak i njohur me origjinën dhe mësimet e

vërteta të këtij sektit, ashtu siç janë edhe shuëm besimtarë të krishterë, ata dukshëm po ngulmohen më tej edhe në qendra të tjera kaq të rëndësishme si Durrësi.

Gjithësesi, për një prezantim më të gjerë me Mormonizmin dhe mësimet e këtij sektit, ju lutem drejtohuni tek faqja jonë në internet duke klikuar [këtu](#).

Fjalori ([versioni online](#))

I Lashti i Ditëve

Kështu është quajtur Perëndia tri herë në vizionin e Danielit (7:9, 13, 22), për të treguar se Ai është i përjetshëm. Ndryshe nga mbretërit tokësorë, ditët e Tij janë të pamatshme.

Inati

Një ndjenjë pakënaqësie, rrjedhojë e diçkaje të keqe në sytë tanë. Ashtu si edhe dashuria, është një ndjenjë e natyrshme, jo domosdoshmërisht e mëkatshme. Por kjo ndjenjë mund të bëhet e mëkatshme në rast se nuk ka shkak, është ekstreme ose e tejzgjatur. (Mat. 5:22; Efes. 4:26; Kol. 3:8). Ndërsa për Perëndinë është një ndjenjë pakënaqësie që Ai ka ndaj mëkatit dhe mëkatarëve (Ps. 7:11)

Pagëzimi i të vdekurve

Përmendet vetëm tek 1 Kor. 15:29. Kjo shprehje e përdorur nga apostulli mund të perifrazohet ndryshe: "Ai që i nënshtrohet një pagëzimi me gjak në mënyrë që t'i bashkohet një kishe të lartësuar e cila nuk ekziston, [në rast se të vdekurit nuk ringjallen] është i marrë. Disa e konsiderojnë këtë shprehje si një aluzion ndaj praktikës së çuditshme, që siç thuhet filloi në Korint. Gjatë kësaj praktike, një person pagëzohej në vend të atyre që kishin vdekur tashmë, para se të pagëzohej vetë dhe shpresohej që këta të fundit do të përfitonin nga një rit i tillë. Mendohej që ky mund të kishte qenë një nga zakonet e gabuara për të cilin Pali shkoi në Korint "për ta vënë në vijë".

Alegori

Është përdorur vetëm tek Gal. 4:24, ku apostulli i referohet historisë së Isakut, i lindur i lirë dhe Ishmaelit, i lindur skllav, duke e përdorur këtë histori në mënyrë alegorike.

Çdo shëmbëlltëri (parabolë) është një alegori. Nathani (2 Sam. 12:1-4) shkon tek Davidi me një tregim alegorik. Në Psalmin tetëdhjetë përdoret një alegori e bukur: "Ti çove jashtë Egjiptit një hardhi" etj. Tek Predikuesi 12:2-6, gjejmë një përshkrim alegorik të goditur për moshën e pleqërisë.

Shënim: Fjalori është një projekt në vazhdim e sipër. Mirëpresim të gjitha pyetjet, sugjerimet dhe këshillat tuaja. [Na Kontaktoni](#)



albKristian.com

E-mail: buletini@albKristian.com

Kush Jemi: [Stafi i albKristian.com](#)

Copyright © albKristian.com – Faqe te Krishtera Shqiptare

Buletini albKristian.com është një shërbesë e albKristian.com – Faqe të Krishtera Shqiptare. Nuk lejohet asnjë lloj përdorimi për qëllime fitimi apo komerciale të çfarëdo lloj forme. Mund të printohet, shpërndahet dhe

përdoret falas ose për qëllime jofitimprurëse pa lejen e autorit. Për çdo lloj përdorimi tjetër ju lutem na kontaktoni paraprakisht për leje.